
TRIBUNA SINDIKALE



Mars 2009

Dhe drit' e diturisë përpara do na shpjerë





Editorial

FSASH:
TE PEZULLOHET DHE TE SHFUQIZOHET UDHEZIMI NR. 4 DATE 05.02.2009 " PER PAGESEN E PUNONJESVE MESIMORE NE DISPOZICION".

Kryesia e Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences i ka derguar nje Leter Ministrit te Arsimit dhe Shkences, z. Fatos Beja, lidhur me shqetesimin e madh qe ka ngjallur ne radhet e mesuesve sindikaliste dhe te strukturave sindikale ne baze Udhezimi nr. 4 date 05.02.2009 " Per pagesen e punonjesve mesimore ne dispozicion".

Permbajtja e Letres eshte si vijon:

MINISTRIT TE ARSIMIT DHE SHKENCES
Z. FATOS BEJA

Z. Minister,

Seksionet Sindikale te FSASH ne Qarkun e Fierit, Vlores,Elbasanit, Durresit, Dibres,etj., kane ngritur prane Federates shqetsimin e madh qe ka ngjallur ne radhet e mesuesve sindikaliste Udhezimi nr. 4 date 05.02.2009 " Per pagesen e punonjesve mesimore ne dispozicion". Mbasi Kryesia e FSASH u njoh me permbajtjen e ketij Udhezimi, ju bejme me dije sa vijon:

1. Udhezimi nr. 4 date 05.02.2009 " Per pagesen e punonjesve mesimore ne dispozicion" eshte ne kundershtim te hapur me Kontraten Kolektive te Punes date 4 Korrik 2006, (neni 4, pika 9), nenshkruar nga Ministri i Arsimit dhe Shkences dhe titullaret e FSASH e SPASH. Ky udhezim eshte ne kundershtim edhe me Udhezimin e meparshem te Ministrit te Arsimit dhe Shkences nr. 29 date 18.09.2006 " Per emrimet dhe levizjet e personelit mesimor dhe drejtues ne arsimin paraun iversitar", i cili i eshte referuar pothuaj ne cdo pike Kontrates Kolektive te Punes dhe zbatimit te saj me korrektesi. Po keshtu, Udhezimi nr. 4 date 05.02.2009 vjen ne kundershtim flagrant edhe me Ligjin per Kodin e Punes, neni 171 e ne vijim.

2. Punonjesit mesimor me kontrate te perkoheshme (shih piken 4 te Udhezimit nr. 29 date 18.09.2006) nuk mund te konsiderohen si mesues ne dispozicion. Koncepti " kontrate pune e perkohesshme" nuk parashikohet as ne ligj as ne KK te Punes. Kontrata njevjecare e Punes qe kane lidhur DAR/ZA me kete kategori mesuesish ka kuptimin e **nje kontrate me afat.** Ne rastin konkret ky afat eshte njevjecar. Si i tille ai nuk mund te nderpritet ne mes te vitit ne menyre te njeanshme pa u perballur me pasojat. Aq me shume Udhezimi nuk mund te kete fuqi prapavepruese, (Udhezimi del me 5 shkurt dhe i shtrine efektet me 1 janar).

3. Nga ky Udhezim praktikisht largohen nga puna rreth 3.000 mesues, te cilet kane deri ne 35 vjet pune si mesues dhe aktualisht jane te punesuar me kontrata pune me afat, kontrate qe, sipas nenit 171 te Ligjit nr. 7961 date 12.7.1995 " Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise" mbrohet nga dispozitat e Kontrates Kolektive te Punes.

4. FSASH eshte befasuar nga fakti se nje udhezim qe sjell si pasoje largimin nga puna te mijera mesuesve, ne kundershtim me Kontraten Kolektive te Punes, eshte bere pa asnje dijeni te Sindikatave nenshkruese te kesaj Kontrate.

Ne keto kushte, kerkojme pezullimin e menjehershem te Udhezimit nr.4 date 05.02.2009 dhe fillimin e negocimeve midis dy partnereve per zgjidhjen ligjore e kontraktuale te ceshtjes.

KRYESIA E FSASH
Tirane, 25.02.2009

PERMBAJTJA

- *Editorial:* FSASH kerkon pezullimin e Udhezimit te Ministrit te Arsimit dhe Shkences, Nr. 4 date 05.02.2009 — 2
- Eliminimi i punes se femijeve kerkon angazhimin e sindikatave dhe aktoreve te tjere — 3
- Me shume angazhim per te rritur me tej rolin e grave mesuese ne sindikate — 5
- 2009-viti i Kongresit te FSASH-it dhe negocimeve per kontraten e re kolektive te punes *Nga mbledhja e KD te FSASH* — 8
- Programi i fushates se zgjedhjeve ne strukturat e FSASH — 10
- Arritjet e seksionit sindikal te FSASH-it Durres, rezultat i punes konkrete ne shkolla — 12
- Normalja e Elbasanit, "Universiteti i pare shqiptar" — 13
- Te reja shkencore dhe keshilla praktike — 15

Kopertina e pare:
Nga punimet e Tryezes me sindikaliste e aktore te tjere per eliminimin e punes se femijeve

Kopertina e fundit:
Nga seminari mbi pjesemarjen dhe rritjen e rolit te grave mesuese ne sindikate

TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 40
Mars 2009
Botim i FSASH dhe SPASH
Me mbeshtetjen financiare te Konfederates se Sindikatave te Holandes, FNV

ADRESA :
Rruga "Dora D'Istria", Pallati Perballe Fakultetit Juridik,Kati i 3-te, Tirane
Tel & Fax + 355 4 225 65 32
Celular: + 355 68 20 34 674,
+ 355 69 22 69 795, + 355 68 21 52 891
E-mail: fsash@abcom-al.com
Internet: www.fsash-spash.com

Keshilli Botues:
Xhafer Dobrushi,
Bajram Kruja,
Lumturi Mataj,
Defrim Spahiu,
Petref Çelaj,
Aleks Dushi,
Stavri Liko, Kryeredaktor

Eliminimi i punes se femijeve kerkon angazhimin e sindikatave dhe aktoreve te tjere qe kane lidhje me problemin

Tryeze e organizuar nga FSASH e SPASH mbi eliminimin e punes se femijeve

Sipas programit, ne zbatim te projektit me FNV/AOb, dy sindikatat tona te arsimit, FSASH e SPASH, organizuan ne Tirane, Tryezen e Rrumbullakte, mbi angazhimin e sindikatave dhe te aktoreve te tjere per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.

Mbi 45 perfaqesues te sindikatave te arsimit, sindikatave te



degeve te tjera ne perberje te KSSH e BSPSH, ILO-IPEC, Inspektoriatit Shteteror te Punes dhe Njesise per Eliminimin e Punes se Femijeve qe vepron prane Ministrise se Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, moren pjese gjate dy diteve te Tryezes, ku u be bilanci i punes se deritanishme dhe u diskutuan probleme te rendesishme qe lidhen me angazhimin e secilit prej ketyre subjekteve ne luften kunder punes se femijeve.

NeTryeze moren pjese, gjithashtu, Kryetari i FSASH-it, Xhafer Dobrushi, Zv/Kryetari i SPASH-it, Defrim Spahiu, Drejtori i Mardhenieve te Punes prane Ministrise se Punes, Bujar Cani dhe perfaqesuesi i sindikates holandeze te arsimit, Marten Kircz.

Ne Fjalen Hyrese te Tryezes, zoti Xhafer Dobrushi theksoi:

Prej me shume se 6-7 vjetesh, parandalimi dhe eliminimi i punes se femijeve perben nje nga drejtimet kryesore te punes se FSASH e SPASH. Sidomos ne kuadrin e zbatimit te projektit te fundit dyvjecar me FNV/AOb, prioriteti i veprimtarise se sindikatave tona te arsimit ne drejtim te parandalimit dhe eleminimit te punes se femijeve eshte bere me i theksuar dhe me rezultativ.

Gjate kesaj periudhe per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, FSASH e SPASH u perqendruam ne pese rrethe:Tirane, Fier, Korce, Durres dhe Elbasan.

Ne keto rrethe jane te punesuar rreth 10 000 mesues ose rreth 33 perqind e mesuesve te arsimit parauniversitar ne shkalle vendi, dhe mesojne mbi 120 000 nxenes te arsimit te detyruar. Nga keta nxenes braktisin cdo vit shkollen rreth 1800 prej tyre, ose rreth 40 perqind e numrit te nxenesve braktises ne shkalle vendi. Afer kesaj perqindjeje eshte edhe numri i nxenesve qe frekuentojne me nderprerje, qe punojne ne rruge dhe perbejne rrezik per braktisje.

Synimi kryesor ka qene dhe mbetet anagzhimi i sa me shume mesuesve, nxenesve e prinderve qe merren me kete ceshtje, sidomos nepermjet aktivizimit te grupeve te punes ne rreth 20 shkolla pilot, nderkohe qe sindikatat kane organizuar aktivitete te shumta per kualifikimin e antereve te grupeve te punes, te drejtuesve lokale, si edhe te vete nxenesve e prinderve, sidomos ne rrethet Tirane, Fier, Durres dhe Korce.

Nder aktivitetet kryesore qe jane organizuar ne kete kuader mund te permendim:

Takime te herepashereshme te grupeve te punes ne shkalle rrethi dhe ne shkollat pilot, duke perdorur forma te ndryshme, si takime vecas ne shkolla, duke perfshire edhe drejtuesit e shkollave dhe mesues te tjere, si edhe takime te perbashketa ne nivel rrethi me pjesemarrjen e anetareve te grupeve ne shkalle rrethi dhe atyre te shkollave, per te njohur arritjet dhe pervojen e njeritjetrit, ku kane marre pjese me

Vijon në faqen 4

Vijon nga faqja 3

shume se 120 mesues nga 21 shkollat pilot.

Kater seminare te organizuar me anetaret e grupeve te punes ne shkalle rrethi e shkolle, ne secilin prej te kater rretheve, ku kane marre pjese mbi 95 drejtues lokale, anetare te grupeve te punes, mesues e sindikaliste.



Dy seminare edhe me pjesemarrjen e perfaqesuesve te nxenesve e te prinderve, ne Tirane, me pjesemarrjen edhe te Korces dhe ne Durres, me pjesemarrjen edhe te Fierit, ku kane marre pjese mbi 20 mesues sindikaliste, mbi 20 perfaqesues te nxenesve dhe mbi 15 perfaqesues te prinderve.

Rreth 1 600 mesues ne shkalle vendi, prej te cileve vetem ne shkollat pilot jane 570 mesues, jane te angazhuar ne punen per uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe per terheqjen e tyre ne shkolle, kryesisht ne shkollat pilot.

Rreth 120 mesues jane te aktivizuar ne grupet e punes dhe me shume se 350 te tjere jane te angazhuar ne keto shkolla, ne mbeshtetje te tyre, sidomos ne punen individuale dhe ne aktivitetet qe jane organizuar ne keto shkolla.

Me shume se 2 400 nexenes, prej te cileve rreth 1 255 vetem ne shkollat pilot, jane subjekt i punes individuale te ketyre mesuesve per mbajtjen e tyre ne shkolle ose kthimin e asaj pjese qe e kane braktisur tashme shkollen.

E gjithe kjo pune eshte shoqeruar me disa rezultate te rendesishme, ne nivel kombetar, nder te cilat mund te permendim:

Me shume se 462 nxenes, vetem nga shkollat pilot, jane kthyer ne shkolle, prej te cileve me shume jane nga shkollat e Durresit, Tiranes, Fierit, Korces dhe Elbasanit.

Mbi 1 800 nxenes, prej te cileve 568 ne shkollat pilot, llogariten te jene tani jasht rrezikut te braktisjes se shkolles, si rezultat i kesaj pune te vecante te bere nga keta mesues.

Rreth 17 perqind eshte ulur numri i nxenesve qe braktisinin shkollen ose ishin ne rrezik per ta braktisur ate, qe llogaritet te jene rreth 6 400 nxenes ne nivel kombetar.

Sidomos mesuesit e shkollave "Naim Frasheri" e "Asdreni" ne Korce, Levan e Roskovec ne Fier, Bathore e Kamez ne Tirane, Ptoleme Xhuvani e De Rada ne Elbasan, 14 Nentori, "Qemal Mici" e "Demokracia" ne Durres, kane bere nje pune konkrete rezultative, duke kthyer ne shkolle nje numer te konsiderueshem nxenesish qe kishin braktisur shkollen dhe duke mbajtur ne shkolle disa nxenes te tjere qe kishin prirje per ta braktisur ate per shkak te rezultateve te ulta ne mesime dhe veshtiresive ekonomike te familjeve te tyre.

Drejtuesit e seksioneve e te grupeve te punes, te cilet moren pjese gjallerisht edhe ne diskutime gjate kesaj Tryeze: Bukuroshe Shabani, Derall Tota, Albina Pepo, Hektor Fejzulla, Lavdosh Llanaj, Shpetim Sino, Bashkim Shyle, Fredi Doraci,

Dilaver Lena, Marie Frroku, Bjeshke Alia ne Bathore, Mersin Terpo, Tafil Ibro, Arqile Bitri, Martha Xharo, Zhaneta Papa, Arjana Plaku, Festim Meta, Maliq Shehaj etj, sollen pervojen e punes se vete, ngriten probleme per nje pune me rezultative ne te ardhmen dhe bene thirrje per nje bashkepunim me te mire edhe me aktore te tjere brenda dhe jashte shkolles.

Perfaqesuesi i sindikates e arsimit te Holandes, Marten Kircz, vleresoi punen e bere nga dy sindikatat tona te arsimit, nga mesuesit ne shkolla dhe drejtuersit sindikaliste ne rrethe, nderkohe qe kerkoi nje angazhim te metejshem, me synimin qe problemi i eliminimit te punes se femijeve dhe mbajtjes se nxenesve ne shkolle te behet ceshtje te gjithe mesuesve, nxenesve, prinderve dhe komunitetit, mbasi vetem keshtu rezultatet e projektit do te jene te qendrueshme dhe do te vijne duke u thelluar e zgjeruar me tej.

Ne Tryeze u theksuan edhe disa

veshtiresi qe hasen gjate punes per realizimin e objektivave te caktuara ne kete drejtim, midis te cilave dhe bashkeveprimi me punedhenesin ne nivel shkolle, DAR/ZA dhe ne nivel Ministrie, i cili nuk eshte i vazhdueshem dhe nuk ka vleresimin qe meriton, bashkepunimi i pamjaftueshem me organet e pushtetit vendor. Po keshtu, shkollat ne pergjithesi, por edhe ato pilot ne vecanti, nuk kane arritur akoma te vleresojne sakte ndikimin e cilesise se sherbimeve qe ofron shkolla, cilesine e punes se cdo mesuesi, ne shkaqet qe ndikojne ne braktisje. Ne mjafte shkolla vazhdon te mungoje baza materiale per disa lende si muzika, fiskultura, artet, qe ndikojne fuqishem ne edukimin



qytetar ne pergjithesi dhe ne terheqjen ne shkolle te kategorise se nxenesve braktises vecanrisht. Ne shkolle ka akoma pak veprimtari kulturore, edukative, sportive me nxenesit, gje qe tregon nivelin e ulet te zhvillimit dhe mungesen e efektivitetit te oreve ekstra kurrikulare.

Dita e dyte e Tryezes filloi me nje prezantim te Kordinatores Kombetare te Zyres se ILO-IPEC ne Tirane, Zj. Etleva Vertopi, e cila u ndale gjeresisht tek standardet nderkombetare te punes se femijeve dhe nenvizoi domosdoshmerine e bashkepunimit me sindikatat dhe aktoret e tjere te perfshire ne parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve ne vendin tone. Ne vijim, perfaqesuesja e Inspektoriatit Shteteror te Punes, Zj.Evis Qaja, foli ne emer te ketij institucioni, ne lidhje me disa konkluzione qe kane te bejne me angazhimet per kontrollin e sektorit informal dhe bashkerendimin e forcave per te mos lejuar punesimin e te miturve nga punedhenes te pandergjegjshem, qe shkelin ligjet dhe shfrytezojne femijet.

Perfaqesuesja e Njesise se Eliminimit te Punes se Femijeve qe vepron ne kuadrin e Ministrise se Punes, Zj. Shkelqesa Manaj, foli mbi rolin e kesaj Njesie dhe nevojen e kordinimit te veprimeve me aktoret e tjere e sidomos me sindikatat, per monitorimin e punes se femijeve dhe eliminimin progresiv te saj. Po keshtu, drejtuesit e sindikatave te ndertimit, Sherif Bulku e Riza Bengasi, te Shendetesise, Minella Mano, te Bujqesise, Nebi Sulejmani e Liri Shehu, te Tekstil-Artizanatit, Hajdar Kanani etj, folen per angazhimin e sindikatave perkatese dhe kerkuan me shume nga institucionet e tjera pjesemarrese, sidomos nga Inspektoriat Shteteror i Punes per kontrollin e sektorit informal dhe marrjen e masave shtrenguese per mospunesimin e femijeve, duke kerkuar penalizimin e atyre punedhenesve qe veprojne ne kundesrshtim me legjislacionin ne fuqi.

Duke e marre fjalen ne kete seance, perfaqesuesi i sindikates holandeze te arsimit, Aob, Marten Kircz, vleresoi angazhimin e sindikatave te degeve te tjera dhe aktoreve te tjere per eliminimin e punes se femijeve, solli pervojen holandeze ne kordinimin e veprimeve midis aktoreve te ndryshem ne kete fushe dhe kerkoi aktivizimin me te mire te medias ne problemet qe lidhen me eliminimin e punes se femijeve.

Nje konkluzion i rendesishem qe doli nga punimet e dites e dyte te Tryezes ishte domosdoshmeria e bashkeveprimit e bashkepunimit me punedhenesit dhe me aktoret e tjere, per ta bere efektiv frontin kunder punes se femijeve, perfshire sindikatat e profesioneve te tjera, komunitetin e prinderve e nxenesve, punedhenesit, organet shteterore ato te pushtetit vendor etj.

Ne Tryeze u paraqit edhe nje draft propozimi per vazhdimin e kesaj pune ne vijim, per nje periudhe 2-3 vjecare, gje qe do te diskutohet ne strukturat e te dyja sindikatave ne qender e ne rrethe dhe do te behet objekt diskutimi edhe ne Konferencen qe pritet te organizohet ne muajin maj te ketij viti.

Stavri Liko

Me shume angazhim per te rritur me tej rolin e grave mesuese ne sindikate

(Nga seminari treditor me grate drejtuese lokale ne sindikata)

Sic ishte planifikuar, seminari mbi pjesemarrjen dhe rolin e grave ne sindikate u zhvillua ne Tirane, me 29, 30 dhe 31 janar 2009.

Grate drejtuese lokale te seksioneve te FSASH dhe SPASH nga 18 rrethe moren pjese ne Seminar dhe ishin shume aktive gjate zhvillimit te tij. Te dy kryetaret e organizatave, Xhafer Dobrushi e Bajram Kruja, moren pjese



gjate seances se hapjes dhe ishin aktive gjate diskutimit te ceshtjeve te vecanta ne disa seanca te tjera.

Perfaqesuesja e sindikates se arsimit te Holandes, Claire Oostvriesland, u bashkua me pjesemarreset ne Seminar diten e dyte e te trete te tij, duke dhene nje kontribut te rendesishem, nepermjet sqarimeve dhe ballafaqimit te pervojave ne lidhje me temat e diskutuara ne Seminar.

Duke qene afer fundit te zbatimit te projektit me sindikatat holandeze FNV /AOb, ky Seminar ishte nje gershetim i vleresimit te asaj qe eshte bere, rezultatave qe jane arritur ne shtimin e anetaresise se te dyja sindikatave me gra mesuese etj, me trajnimin e pjesemarreseve ne seminar, vecanerisht ne lidhje me legjislacionin shqiptar mbi barazine gjinore, rolin e komiteteve te grave ne mbeshtetjen e progresit te grave mesuese ne profesion, rolin e vecante te grave mesuese per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve etj.

Ne fjalen e hapjes, ne mer te te dy sindikatave, kryetari i FSASH-it, Z. Xhafer Dobrushi vleresoi punen qe eshte bere deri tani, ne kuadrin e plotesimit te objektivave te Projektit, dhe shtroi detyra te reja per forcimin dhe konsolidimin e komiteteve te grave per te realizuar objektivat per te ardhmen, te caktuara nga vete ato, per njohjen e problemeve specifike te grave mesuese dhe mobilizimin e sindikatave te arsimit per trajtimin dhe zgjidhjen e tyre, si dhe per t'i bere objekt te negociatave per Kontraten e re Kolektive te Punes.

Prezantimet dhe tere organizimi i seminarit u realizuan nga vete grate drejtuese ne nivel organizatash ne qender e ne rrethe. Rol te vecante per pergatitjen dhe zhvillimin e ketij Seminari luajten grate drejtuese lokale, Bukuroshe Shabani, Fatbardha Keço Reihan Shkreta, Lumturi Mataj, Elizabeta Myftari, Zela Koka etj.

Nje prezantim interesant ne lidhje me kuadrin ligjor per kete ceshtje u be nga Drejtoresha e Drejtorise se Mundesive dhe Politikave te Barabarta, Zj. Anna Xheka, e cila trajtoi gjeresisht probleme te rendesishme te shoqerise sone e ne vecanti te grave, karakteristikat kryesore te ligjit te ri dhe te legjislacionit shqiptar ne pergjithesi, si edhe rolin e organeve shteterore, bashkepunimin me sindikatat dhe institucionet dhe organizatat e tjera te interesuara per kete ceshtje.

Nepermjet pyetjeve qe bene grate mesuese dhen diskutimeve ne lidhje me kete ceshtje, u sqaruan mjaft probleme dhe u percaktuan disa nga synimet kryesore te bashkepunimit ne te ardhmen.

Duke analizuar gjendjen aktuale, ne seminar, si nepermjet prezantimeve, ashtu edhe ne diskutime, u evidentua se rrethe si Tirana, Elbasani, Korca, Durresi, Vlora, Fieri, Shkodra, Librazhdi, Skrapari, Kucova etj, kane arritur rezulate te mira ne punen me grate meusese, duke rritur numrin e tyre ne sindikata dhe duke konsoliduar komitetet e grave prane seksioneve sindikale perkatese. 16 rrethe te tjera kane bere progres te dukshem ne keto drejtime, nderkohe qe 8 rrethe jane ne proces riorganizimi dhe konsolidimi.

Puna konkrete qe eshte bere, sidomos gjate vitit te fundit, reflektohet edhe ne rritjen e numrit te grave mesuese ne sindikata prej 2 075 gra nga te dyja sindikatat, FSASH e SPASH. Eshte rritur, gjithashtu, edhe pjesemarrja e grave mesuese ne aktivitetet sindikale, sidomos ne aktivitetet e organizuara ne kuadrin e zbatimit te Projektit me FNV/AOb. Me shume se 120 gra mesuese jane angazhuar ne aktivitetet konkrete qe jane organizuar per kete qellim, si grupe pune, anketime, tryeza e seminare, etj. Po keshtu, nga 120 pjesemarres ne seminaret dhe grupet e punes qe jane organizuar ne lidhje me parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, 68 kane qene gra, nderkohe qe nga 202 pjesemarres ne takimet, tryezat dhe aktivitetet e tjera qe jane organizuar ne kete kuader, ne lidhje me dialogun social ne sektorin e arsimit dhe sigurimin e me shume sherbimeve per mesuesit

anetare te sindikatave, 102 kane qene gra, ndersa nga 71 pjesemarres ne grupet e punes, takimet dhe aktivitetet e tjera te organizuara per konsolidimin e seksioneve sindikale, 43 kane qene gra.

Me shume interes u ndoq seanca mbi angazhimin e grave mesuese dhe rolin e vecante te tyre per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, ku mesueset qe jane marre direkt me kete problem dhane eksperiencen e tyre dhe u shkembyen mendime per permiresimin e metejshem te kesaj pune, jo vetem ne rrethet ku ne jemi nagazghuar ne kuadrin e Projektit, por edhe me gjere.

Me shume efektivitet ishte puna ne grupe, ku secila prej tyre demonstroi nje plan konkret te aktiviteteve te zhvilluara ne zbatim te detyrave qe dolen nga Tryeza e zhvilluar ne pranveren e vitit te kaluar dhe u be nje shkembim experience mjaft e bukur, ku dolen mendime te vlefshme per vazhdimesine e punes se komiteteve dhe grupeve te grave mesuese. Ne grupe u bene diskutime konkrete dhe u trajtuan probleme te ndryshme, si organizimi i trajnimeve per te rritur numrin e grave te pergatitura e te afta per te perballuar punet e sindikates, si dhe per t'iu pergjigjur kerkesave dhe stadit aktual te zhvillimit te arsimit. Gjate punes ne grupe dolen, gjithashtu, detyra konkrete per rritjen e rolit te grave sindikaliste ne zhvillimin e reformes ne procesin arsimor ne vendin tone, per menazhimin dhe drejtimin e arsimit, per rritjen e aktivizimit te grave mesuese per te dhene mendime e propozime konkrete per permiresimin e legjislacionit ne lidhje me statusin e grave ne pergjithesi dhe te grave mesuese ne vecanti, per miratimin e Statusit te Mesuesit etj. Gjate punes ne grupe, u dalluan sidomos mesueset Albina Pepo, Valbona Mino, Adelina Shperdheja, Elisabeta Myftari, Enriketa Zeqo, Qazime Dardha, Najada Hasani, etj, te cilat transmetuan, jo vetem mendimet e veta, por edhe ato te pjesetareve te tjera te grupit, gjate raportimeve qe u bene ne seancat plenare.

Nepermjet nderhyrjeve dhe shpjegimeve ne Seminar, ekspertja e AOb, Claire Oostvriesland, vuri ne dukje punen e mire qe eshte bere, por theksoi se mbetet akoma me shume per te bere. Ajo theksoi se duhet te punohet ne te tre nivelet nga qendra ne baze, me plane konkrete. Ajo insistoi per ndermarrjen e veprimeve konkrete nga ana e te dyja sindikatave me grate mesuese, jo vetem duke organizuar trajnime sindikale, por edhe profesionale, duke synuar permiresimin e metejshem te kushteve te punes per grate mesuese, si edhe per mesuesit ne teresi, nepermjet nje dialogu social efektiv dhe rritjes se rolit te seksioneve sindikale ne rrethe per punen me grate mesuese.



Rezultatet, nenvizoi kolegia Claire, arrihen kur analizojme konkretisht cfare eshte bere, si eshte bere dhe kush e ka bere. Ne kete menyre, puna ecen perpara dhe, kur qellimi arrihet, ju duhet te festoni suksesin. Keto fjale te koleges sone holandeze bene shume pershtypje ne radhet e grave mesuese pjesemarrese ne seminar dhe do te jene lajtmotivi yne per ta cuar punen tone akoma me perpara

Pas diskutimeve konkrete, u miratua nje Plan Veprimi, ku u percaktuan detyra konktrete, sidomos ne lidhje me punen qe pritet te behet kete vit, duke synuar te terhiqen me shume gra ne sindikate, te mbeshteten kandidaturat e grave per ne organet drejtuese te sindikatave nga qendra ne baze, te konsolidohen me tej komitetet e grave, si edhe te perdoren efektivisht zgjedhjet e reja ne sindikata, kontrata e re kolektive e punes, Statusi i Mesuesit etj, per te permiresuar gjendjen e grave mesuese ne sindikate dhe ne profesion.

Per rritjen e numrit te anetareve te reja, u percaktuan detyra per shtimin e sherbimeve, duke patur nje vizion te qarte, duke bere analiza konkrete dhe duke percaktuar detyra konkrete, sidomos ne drejtim te zgjerimit dhe konsolidimit te komiteteve te grave, rritjes se numrit dhe te rolit te grave drejtuese ne struktuart e sindikatave, forcimit te bashkepunimit me administratat e shkollave, si edhe organet e nxenesve e prinderve.

Konkluzionet qe dolen nga ky Seminar dhe detyrat konkrete qe u percaktuan ne Planin e Veprimit do te perpunohen me tej, do te ndiqen per zbatim nga kryesite e te dyja sindikatave, nga seksionet sindikale ne rrethe, si edhe nga vete komitetet e grave ne qarqe e rrethe, dhe do te shqyrtohen me tej edhe ne Konferencen Vleresuese qe do te zhvillohet ne maj te ketij viti.

Me nje aktivitet argetues, grate mesuese, drejtuese te grupeve e komiteteve te grave, e perfunduan Seminarin per te filluar nje pune me konkrete per vitin 2009 e ne vijim.

Fatbardha Keço

2009-viti i Kongresit te FSASH-it dhe negocimeve per kontraten e re kolektive te punes

Nga mbledhja e KD te FSASH

Analiza vjetore e punes se Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, FSASH, per vitin 2008 dhe programi e detyrat kryesore per vitin 2009, u bene ne mbledhjen e posacme te Keshillit Drejtues te kesaj Federate, e cila u zhvillua ne Tirane, me pjesemarrjen e drejtuesve te seksioneve sindikale dhe anetareve te tjere te ketij keshilli nga me shume se 30 rrethe te vendit.



Ne Fjalen Hyrese qe mbajti Kryetari i kesaj Federate, z. Xhafer Dobrushi, ne emer te Kryesise, beri vleresimin per punen e bere dhe rezultatet e arritura gjate vitit 2008, dhe paraqiti drejtimet kryesore te punes dhe sfidat me te cilat do te perballen strukturat e kesaj Federate nga qendra ne baze gjate vitit 2009.

Qe ne fillim, ai theksoi se viti 2009 eshte nje vit shume i rendesishem per levizjen sindikale te Federates sone, mbasi ky eshte edhe viti i zgjedhjeve per organet drejtuese te saj, ne te gjitha nivelet, deri tek Kongresi i 4-t i saj, i cili do te mbahet ne datat 6 dhe 7 nentor 2009, si dhe viti i negocimeve per kontraten e re kolektive te punes, mbasi kontrata ekzistuese e mbaron afatin ne fund te dhjetorit.

Ne mund te pohojme me kenaqesi, theksoi me tej ai, se objektivat kryesore, persa i perket levizjes sone sindikale per vitin 2008 jane realizuar me sukses. Krahas konsolidimit te metejshem te seksioneve sindikale qe tani kane nje pervopje pozitive disavjecare si Tirana, Vlora, Fieri, Skrapari, Mallakastra, Devolli, jane rioganizuar dhe tani funksionojne normalisht seksionet sindikale ne Gramsh, Berat, ku ne krye te seksioneve jane zgjedhur dy djem te rinj, te cilet jane shume aktive, jo vetem ne rrethet perkatese, por edhe ne aktivitetet kualifikuese qe zhvillohen ne kuadrin e Konfederates.

Ne kete rruge po ecin edhe seksionet sindikale te Durresit, Mirdites, Kuksit, Elbasanit, Tropojes, Matit, Tiranes Rreth etj, ku jane bere permiresime te ndjeshme dhe ne presim rezultate konkrete ne permbushjen e objektivave te levizjes sindikale ne keto rrethe per vitin 2009.

Ne kete analize u theksua se me shume pune kerkohet nga drejtuesit e seksioneve sindikale te Shkodres, Lezhes, Korces, Kavajes, etj., te cilat duhet ta masin punen e tyre me arritjet konkrete ne plotesimin e objektivave dhe synimeve qe te gjithe se bashku i vendosim ne kete forum te larte te sindikates sone.

Nderkohe, objektiv i rendesishem i strukturave te Federates mbetet riorganizimi i seksioneve sindikale ne Lushnje, Kruje, Malesi e Madhe, Peqin, dhe Delvine

Detyrat e tjera qe dalin nga zbatimi i Kontrates Kolektive, sic jane

Statusi i mesuesit, pagesa e shpenzimeve per viziten e detyrueshme mjekesore, rritja e perqindjes per pagesen e vjetersise ne pune, etj, do te ndiqen duke dialoguar me MASH.

Ne lidhje me Fushaten e zgjedhjeve, zoti Xhafer Dobrushi paraqiti per diskutim e miratim Programin perkates, ku nenvizohen objektivat qe do te arrihen, si edhe fazat e zhvillimit te saj deri ne Kongres.

Ne vijim, Sekretari i Pergjithshem i Federates, Stavri Liko, paraqiti Raportin mbi veprimtarine ekonomiko-financiare te Federates per vitin 2008 dhe projekt buxhetin per vitin 2009.

Ne raport theksohet se bilanci financiar i FSASH edhe per vitin 2008 ka pothuajse te njejtat karakteristika si ai i ketyre tre-kater viteve te fundit, megjithe pengesat ne rritje, sidomos per shkak te disa veshtiresive sociale dhe ekonomike me te cilat perballen shumica e mesuesve dhe familjeve te tyre.

Pasi paraqiti shifrat konkrete per te ardhurat e shpenzimet, raporti thekson se ka akoma shume rezerva per rritjen e te ardhurave nga kuotizacioni, nderkohe qe shpenzimet konsiderohen normale per nje aktivitet kaq te gjere sic eshte ai i FSASH-it.

Ne raport u theksua se peshen kryesore ne realizimin e te ardhurave nga kuotizacioni vazhdojne ta mbajne rrethet qe kane krijuar nje tradite tashme ne kete drejtim si: Tirana Qytet, Fieri, Vlora, Skrapari, Mallakastra, Permeti, Tepelena, Kucova, etj.

Disa rrethe si Dibra, Mati, Bulqiza dhe Durresi, kane bere permiresime te dukeshme gjate vitit 2008, krahasuar me 2007, gje qe perben nje baze te mire per ta vazhduar kete pune edhe gjate ketij viti e ne vijim.

Rrethe me peshe si Shkodra, Korca, Kuksi nuk mund te justifikohen me gjendjen e te ardhurave nga kuotat per vitin 2008. Po keshtu nuk mund te justifikohen edhe Gjirokastra e Kolonja, ku akoma nuk ka ndonje rezultat konkret per kete vit.

Nderkohe u terhoq vemendja per disa rrethe si Tirana Rreth, Kavaja, Kurbini, Pogradeci, Librazhdi, te cilet kane renie gjate vitit 2008, krahasuar me 2007-en, gje qe duhet analizuar, ne radhe te pare, nga vete drejtuesit e ketyre seksioneve, per te bere permiresimet e nevojeshme sa me pare gjate ketij viti.

Me riorganizimiet qe u bene ne Berat e Gramsh, dhe me ato qe jane ne proces ne Elbasan e Mirdite, pritet qe te kemi prej tyre kontribute te reja.

Detyra konkrete u percaktuan per rrethet Delvine, Has, Kruje, Lushnje, Malesi e Madhe, Peqin, ku vazhdojme te kemi probleme te medha edhe organizimi e funksionimi, prandaj na duhet te perqendrohemi per riorganizime konkrete gjate ketij viti.

Me propozim te Kryesise, Keshilli diskutoi, gjithashtu, edhe per mundesine e rritjes se mases se kuotes mujore nga 50 ne 100 leke, duke synuar qe t'i afrohemi mases qe kemi percaktuar ne Statut dhe te kemi mundesi qe te realizojme me shume sherbime per ata anetare qe paguajne kuoten e anetaresise.

Bazuar ne kete perspektive, projektbuxheti i vitit 2009, i paraqitur per miratim ne kete mbledhje kishte tregues me te larte, krahasuar me vitin 2008, si persa u perket te ardhurave, ashtu edhe shpenzimeve, gje qe u mireprit dhe u miratua nga nga anetaret e Keshillit.

Te gjithe diskutantet qe folen ne mbledhje analizuan situaten ne rrethet perkatese dhe shprehen vendosmerine per te bere permiresimet e nevojeshme per realizimin e objektivave te vitit 2009.

Nderkohe drejtuesit e seksioneve qe e moren fjalen, si Istref Haxhillari, Pogradec, Mehmet Cane, Kolonje, Petref Celaj, Vlore, Neim Hajderaj, Mallakaster, Filip Rajta, Kurbin, Perparim Musabelliu, Skrapar, Hysen Gaçi, Sarande, Dilaver Dika, Mat, Bashkim Shyle, Durres, ngriten edhe mjaft probleme qe kane te bejne, sidomos me shtimin e sherbimeve per anetaret, zgjidhjen e problemit te dhenies se deri dy pagave per mesuesit qe dalin ne pension, duke kundershtuar reduktimin e saj vetem ne nje page, pagesen nga shteti te shpenzimit te vizites mjekesore te detyrueshme per mesuesit per vertetimin per shkak te profesionit, per mbrojtjen me te mire te anetareve, kur ata ndeshen me qendrime te padrejta ne mardheniet e punes, per forcimin e bashkepunimit me drejtorite dhe zyrat arsimore dhe me drejtorite e shkollave, si edhe per insistimin ne realizimin e motivimit me te mire te mesuesve qe kane rezultate te mira ose qe aktivizohen ne veprimtari jasht kohes normale te punes, per vleresimin e negocimeve per kontraten e re kolektive te punes, me qellim qe ajo te nenshkruhet brenda afatit te mbarimit te kontrates ekzistuese etj.

Pas diskutimeve, Keshilli Drejtues miratoi programin e punes dhe objektivat e FSASH per vitin 2009, si edhe buxhetin perkates, duke nenvizuar domosdoshmerine e permiresimit te metodes se punes ne te gjitha nivelet nga qendra ne baze, si kusht i domosdoshem per t'iu pergjigjur detyrave ne rritje gjate ketij viti.

Korresp. "Tribuna Sindikale"

PROGRAMI I FSASH PER ZHVILLIMIN E FUSHATES SE ZGJEDHJEVE NE TE GJITHA STRUKTURAT E SAJ

Periudha 15 mars- 15 nentor 2009

Keshilli Drejtues i FSASH, i mbledhur me 13 shkurt 2009, mbeshtetur ne Statutin e Federates, miratoi programin e fushates se zgjedhjeve ne te gjithe strukturat e FSASH, qe do te zhvillohen nga 15 marsi deri me 15 nentor 2009.

Fushata do te sherbeje per te ndermarre nje veprimtarie sindikale me te ngjeshur, me intensive dhe me cilesore, per te plotesuar me mire kerkesat dhe interesat e anetareve dhe te te gjithe punonjesve te arsimit e shkences, nga njera ane, dhe per te rritur rolin dhe angazhimin e FSASH, si partner social, ne procesin e reformimit dhe modernizimit te sistemit arsimor ne vendin tone.

OBJEKTIVAT KRYESORE TE FSASH NE KUADER TE FUSHATES JANE:

1. Per funksionimin statutor i te gjithe strukturave te Federates:

a- Duke u mbeshtetur ne pervojen e Seksioneve Sindikale te perparuara, te punohet per konsolidimin e seksioneve sindikale ekzistuese dhe te behet riorganizimi e freskimi i seksioneve ne ato rrethe ku veprimtaria e tyre eshte akoma e dobet ose inekzistente.

b- Te organizohen seksionet sindikale ne rrethet Kruje, Lushnje, Has, Malesi e Madhe, Peqin dhe Delvine.

c- Te punohet per rritjen e perfaqesueshmerise, nepermjet permiresimit dhe shtimit te sherbimeve qe FSASH u ofron anetareve, duke synuar per rritjen e anetaresise nga radhet e grave dhe te rinjve.

d- Te mbeshtetemi ne nje standard ne shtimin e anetaresise: vetem anetare me kuote.

e- Te krijohen, gjallerohen e konsolidohen sindikatat ne arsimin e larte publik, ne administraten arsimore dhe ne arsimin jopublik.

2. Per rritjen e rolit dhe pergjegjesise se sindikates per zbatimin e reformes ne arsim dhe modernizimin e arsimit.

a. Te perfshihen te gjithe strukturat e zgjedhura dhe sindikalistet mesues ne procesin e reformes dhe modernizimin e arsimit, per ta vene mesuesin dhe figuren e tij ne qender te ketij procesi dhe per te ushtruar ndikim ne njohjen dhe zbatimin e Strategjise se Arsimit Parauniversitar edhe ne nivel shkolle.



b. Te sigurojme ndjekjen ne proces dhe ne vazhdimesi te zbatimit te dispozitave te Kontrates Kolektive te Punes te nivelit te pare, dhe te Kontratave te nivelit te dyte.

c. Te kembengulim me me force per zbatimin me pergjegjesi te detyrimeve qe ka punedhenesi per kualifikimin e mesuesve, perfshire dhe ata pa arsim perkates, me qellim qe mesuesit e punesuar ne sistem t'u pergjigjen kerkesave bashkekohore per rritjen e aftesive profesionale ne sherbim te arsimimit cilesor.

d. Te kerkojme nga punedhenesi dhe nga pushteti vendor, qe sidomos ne Tirane dhe ne disa qytete te tjera, te rriten investimet per ndertimin e shkollave, me qellim qe te permiresohen kushtet e punes dhe te mesimdhenies dhe te normalizohet gradualisht numri i nxenesve ne klase.

3. Per te rritur forcen e sindikates per mbrojtjen sociale te sindikalisteve dhe punonjesve te arsimit dhe shkences.

a. Rritja efektive dhe permiresimi i sistemit te pagave do te mbetet edhe ne te ardhmen objektiv kryesor i FSASH. Ne kete kuader, Federata do te negocoje intensivisht me MASH

per te perpunuar e perfshire ne KK te Punes te nivelit te pare norma ligjore qe inkurajojne e shperblejne me mire cilesine e mesimdhenies ne arsim, per te shperblyer mesuesit qe angazhohen dhe arrijne rezultate ne uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe te atyre qe frekuentojne me nderprerje dhe punojne ne rruge, per te mbeshtetur perpjekjet dhe rezultatet e mesuesve ne rritjen e aftesive profesionale dhe te punes kerkimore shkencore.

b. FSASH do t'i vazhdoje perpjekjet per permiresimin e akteve nenligjore qe trajtojne dhe disiplinojne Fondin e Vecante dhe harmonizimin e ketyre dispozitave me Kontraten Kolektive te Punes.

c. Ne muajt e pare te ketij viti do te fillojne diskutimet me perfaqesuesit e MASH per permiresimin e Kontrates Kolektive te Punes te nivelit te pare dhe per hartimin e draftit per Statusin e Mesuesit.

FAZAT E ZHVLLIMIT TE FUSHATES:

Sipas vendimit te KD te FSASH periudha zgjedhore ndahet ne dy faza:

Faza e pare, fillon me 15 mars dhe perfundon me 15 maj 2009.

Ne kete faze behen analizat e veprimtarise sindikale dhe zgjedhjet ne organizatat sindikale ne baze, perfshire shkollat, kopshtet, fakultetet dhe administraten arsimore arsimore.

Kjo faze eshte shume e rendesishme, per aresye se ne te duhet te perfshihet e gjithe masa e sindikalisteve, qe eshte forca kryesore per analizen e drejte dhe zbatimin e objektivave qe ka shpallur Federata per kete fushate.

Prandaj fushata nuk duhet te thjeshtohet e identifikohet vetem me diten e caktuar per zgjedhjet. Ajo duhet te perfshije nje periudhe pergatitore disajavore me masa konkrete, me takime e biseda me anetaret, me veprimtari sindikale, ku te synohet vecanerisht terheqja e mendimit te anterave per problemet qe preokupojne sindikaten dhe anetaret e saj.

Sindikatat ne baze duhet te bejne kujdes per zbatimin e normave demokratike qe permban Statuti i FSASH per zhvillimin e gjithe procedurave te analizes dhe zgjedhjeve dhe finalizimin e ketij procesi me detyra konkrete per permiresimin e punes ne te ardhmen.

Seksionet sindikale duhet te hartojne grafikun e zhvillimit te zgjedhjeve ne secilen organizate, te caktojne te deleguar te tyre ne keto mbledhje dhe te ndjekin me pergjegjesi gjithe ecurine fushates deri ne mbledhjen per dhenie llogari e zgjedhje.

Faza e dyte, fillon me 1 shtator dhe perfundon me 31 tetor 2009.

Ne kete faze do te behen analizat e punes dhe zgjedhjet ne Seksionet Sindikale ne baze rrethi dhe qarku. Nderprerja per shkak te provimeve dhe pushimeve verore nuk duhet te ndikoje ne zbehjen e fushates. Perkundrazi, ajo duhet te konsiderohet si vazhdim logjik i gjithe fazes se pare dhe te perbeje analizen dhe pergjithesimin e problemeve, shqetesimeve dhe synimeve qe do te dalin nga organizatat sindikale.

Mbeshtetur ne analizat dhe problemet qe do te evidentohen ne fazen e pare, Seksionet Sindikale duhet te bejne pergjithesime per veprimtarine e tyre ne shkalle rrethi ose qarku, te evidentojne kerkesat, shqetsimet dhe problemet me te cilat jane ballafaquar dhe te vleresojne menyren dhe nivelin e zgjidhjes se tyre, te analizojne ne menyre kritike nivelin e dialogut social me punedhenesin dhe bashkeveprimin me shoqerine civile, te bejne nje analize te shendoshe te funksionimit te strukturave sindikale ne baze dhe ne nivel rrethi e qarku, perfshire shtimin e radheve te sindikates, punen me seksionet e grave dhe te rinise, angazhimin dhe arrijet ne programin per eliminimin e punes se femijeve dhe uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen ose frekuentojne me nderprerje.

Procedura e zhvillimit te mbledhjes se Seksionit te mbeshtetet ne Statutin e FSASH, duke perfshire zgjedhjen e organeve drejtuese, te delegateve per ne Keshillin Sindikal te rrethit, te perfaqesuesve per ne Keshillin Sindikal Rajonal, si edhe zgjedhjen e delegateve te Kongresit te Katert te FSASH.

Seksioni sindikal duhet te informoje ne menyre te vazhdueshme Kryesine e FSASH per gjithe procesin e zhvillimit te zgjedhjeve ne organizatat sindikale dhe ne Seksion.

Mbas perfundimit te fazes se dyte te zgjedhjeve, ne Seksionet Sindikale do te zhvillohet Kongresi i FSASH-it.

Sipas Vendimit te Keshillit Drejtues, Kongresi i Katert i FSASH do te mbahet ne Tirane, me 6 -7 Nentor 2009.

Norma e perfaqesimit per ne Kongres do te jete: 1 delegate per 100 anetare.

Kongresi i Katert i FSASH:

a) do te degjoje dhe diskutoje raportet llogaridhenese te Keshillit Drejtues dhe te Komisionit te Finances si dhe do te percaktoje objektivat e FSASH per kater vitet e ardhshme.

b) do te miratoje ndryshimet dhe permiresimet qe i behen Statutit te FSASH.

c) do te zgjedhe organet drejtuese, perfshire Kryetarin e FSASH-it, Keshillin Drejtues, Komisionin e Finances dhe delegatet per Kongresin e KSSH-se.

Per zbatimin e ketij Programi, Keshilli Drejtues i FSASH- it ngarkon Kryesine e Federates dhe Kryetaret e Seksioneve sindikale te rretheve.

Tirane, 13.02.2009

KESHILLI DREJTUES I FEDERATES SE SINDIKATAVE TE ARSIMIT DHE SHKENCES

Arritjet e seksionit sindikal te FSASH-it Durres, rezultat i punes konkrete ne shkolla

Pas nje pune intensive prej me shume se gjashte muajesh, u mblodh seksioni sindikal i FSASH per rrethin e Durresit, ku merrnin pjese kryetaret e keshillave sindikale te 19 shkollave te ketij rrethi.

Ndodheshin edhe Kryetari i FSASH-it, Xhafer Dobrushi dhe kryetari i KS te Konfederates per rrethin e Durresit, Luan Zaza.

Ne raportin qe mbajti i ngarkuari i Federates ne krye te grupit te punes per riorganizimin e ketij seksioni, Verdha, Aferdita Kaci, Rajmonda Aliu, Safet Dollani, Redi Demiri, Mentor Onuzi, Violeta Hoxha, Petrit Gjoka, Dhimiter Mele, Emin Bala, Diana Halucaj, Fiqiri Metaliu, Mirela Mehmetaj, Qerim Bala, Qemal Lika, Bardha Stavre e mjaft te tjere, te cilet, gjithashtu, moren pjese ne takim dhe ngriten probleme te rendesishme qe kishin te benin sidomos me sigurimin e vendit te punes, miratimin e Statusit te Mesuesit, shmangien e levizjes pa kritere te mesuesve, zbatimin e



mesuesi Bashkim Shyle, u vu ne dukje se puna u organizua duke shkuar shkolle me shkolle, duke folur me mesuesit, sidomos per rolin e Federates per mbrojjen e te drejtave social - onomike te tyre, per permiresimin e kushteve te punes dhe shperblimit per punonjesit e sistemit arsimore, por edhe per kontributin ne drejtim te reformes arsimore, kushteve te punesimit etj.

Si rrjedhoje e kesaj pune, theksoi ai, ne rrethin e Durresit jane ngritur keshillat sindikale ne 32 shkolla, me rreth 590 anetare, realitet ky qe eshte nje arritje e madhe per FSASH-in ne kete rreth.

Ne takim u vleresuan per nje pune rezultative sidomos mesuesit : Majlinda Spahiu, Diana Gjika, Vasil Nisi, Rebeka Kontrates Kolektive per marrjen e deri dy pagave per mesuesit qe dalin ne pension, motivimin e mesuseve qe punojne jashte kohes normale dhe kane rezultate te mira ne mesimdhenie dhe ne shmangien e braktisjes se shkolles dhe eliminimin e punes se femijeve etj.

Nepermjet nderhyrjeve gjate takimit, kryetari i FSASH-it, Xhafer Dobrushi theksoi se Federata do te mbeshtese nga afer seksionin sindikal te rrethit te Durresit, nderkohe qe ne jemi duke punuar per pergatitjen e draftit te Statusit te Mesuesit, te cilin synojme qe te miratohet brenda ketij viti. Ofrimi i sa me shume sherbimeve per anetaret eshte, gjithashtu, nje synim tjeter i Federates, per te cilen ne do te shfrytezojme takimet qe do te bejme se shpejti me drejtuesit kryesore te Ministrise se Arsimit dhe Shkences, si edhe bisedimet per kontraten e re kolektive te punes, e cila do te nenshkruhet nga fundi i ketij viti, kur i mbaron afati kontrates aktualisht ne fuqi. Me tej, ai theksoi angazhimet e Federates per mbrojtjen e mesuesve nga veprimet antiligjore te segmenteve te caktuara, sidomos ne lidhje me punesimin, duke permendur rastin e fundit qe ka te beje me Udhezimin Nr. 4, dt 5 shkurt 2009, i cili, ne kundershtim me Kodin e Punes, Kontraten Kolektive te Punes dhe Udhezimet e mepareshme te vete Ministrise, synon te ndryshoje statusin e mbi 3 000 mmesuesve dhe t'i kaloje ata ne mesues qe do te paguhen me ore, duke i sjelle nje dem te madh, jo vetem ketyre mesuesve, por, ne radhe te pare, vete nivelit te mesimdhenies ne vendin tone. Federata do te angazhohet per mbrojtjen e ketyre mesuesve, nepermjet bisedimeve ne Ministri dhe, nese do te jete e nevojshme, edhe me veprime sindikale.

Mbeshtetje per kete seksion premtoi edhe kryetari i Keshillit Sindikal te rrethit, Luan Zaza, gjate nderhyrjeve te tij ne takim.

Mbledhja miratoi nje program konkret pune ne lidhje me organizimin e sindikatave ne shkollat e tjera te sistemit parauniversitar dhe ne Universitetin e Durresit, ndjekjen per zgjidhje te disa problemeve qe jane ngritur gjate takimeve me mesuesit ne shkollat ku eshte organizuar tashme sindikata, si edhe me zbatimin e kontrates kolektive te punes, angazhimin per uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve etj.

Seksioni beri edhe zgjedhjet, ku me unanimitet kryetar u zgjodh zoti Bshkim Shyle.

Me rastin e 7 Marsit, ditës së Arsimit tonë Kombëtar:

NORMALJA E ELBASANIT, "UNIVERSITETI I PARË SHQIPTAR"

Nga: Prof.as.Dr. MURAT GECAJ

Siç dihet, nga data 2-9 shtator 1909 u mblodh Kongresi i njohur i Elbasanit. Në vendimin e tij, ndër të tjera, thuhej:

"Të fillohet edhe të niset këtë vjeshtë n' Elbasan një mësonjëtore për mësonjës, shkollë Normale, me gjashtë rreshta. Për përmbajtjen e saj janë të detyruara të gjitha klubet edhe shoqëritë, mbrenda dhe jashtë Shqipërisë, sikundër gjithë njerëzit, që dëshirojnë përparimin e Kombit shqiptar". Kjo detyrë e lartë atdhetare u përmbush në fillimin e dhjetorit të atij viti dhe kështu nisi jetën kjo shkollë me emër të ndritur në historinë e arsimit tonë kombëtar.

Në vazhdimësi, më 10 tetor 1909, komisioni i ngritur posaçërisht publikoi një "Zëdhënje", ku njoftonte hapjen e kësaj shkolle dhe disa nga synimet e saj, kërkesat për nxënësit e prindërit etj:

"Shkolla do të ketë 6 klasë, prej të cilave 3 do të jenë për të përgatitur (premtare) dhe 3 thjesht normale; po sivjet do të ketë vetëm 3 premtare dhe një normale. Në klasën e parë do të hyjnë nxënësit që kanë mbaruar një shkollë të parë në cilëndo gjuhë dhe në klasët e tjera ata, që kanë mbaruar klasa më të larta". Më tej tregoheshin disa nga lëndët, që do të zhvilloheshin, se do të hapej dhe një konvikt për nxënësit etj

Për këtë ngjarje të gëzueshme, pra çeljen e Normales të Elbasanit, ka shkruar edhe prof. dr. Aleksandër Xhuvani, "Mësues i Popullit". Ai pohonte:

"Në Normalen e Elbasanit u mblodhën atëhere nxënës nga gjithë viset e Shqipërisë e në mes tyre edhe shumë nxënës nga Kosova, të mbledhur e të dërguar me përpjekjet e patriotit kosovar



Hasan Prishtina. L. Gurakuqi u zgjodh drejtor i shkollës. Ndër profesorët e asaj shkolle janë për t'u përmendur, veç meje dhe Gurakuqit: Sotir Peci, Petër Dodbiba, Simon Shuteriqi, Hasan Mezja dhe Hafiz Ibrahim Dalliu nga Tirana. Normalja punoi për një vit plot. Në mbarim të vitit u bënë edhe provimet e fundit me një solemnitet të madh. L. Gurakuqi mbajti një ligjëratë të bukur, që u botua pastaj nëpër gazetat".

Siç pritej, hapja e shkollës Normale u pa me sy të keq nga pushtuesit osmanë dhe armiqtë e tjerë të popullit e të shkollës shqipe. Ndërsa u mbështet fuqimisht nga atdhetarët shqiptarë, brenda e jashtë vendit. Ajo u mbajt nga fondet e shoqërisë "Përparimi" të Korçës (me kryetar Orhan Pojanin), u administrua dhe u udhëhoq nga personel pedagogjik shqiptar laik, u përshkua nga fryma e edukimit atdhetar, larg ndikimeve të huaja. Për të, dhanë ndihmesën e tyre të çmuar edhe disa klube shqiptare, që vepronin jashtë Shqipërisë.

Një punë të madhe për përballimin e nevojave të Normales, sidomos me tekste, dha vetë prof. Xhuvani. Ai hartoi e botoi manualet dhe tekstet e para origjinale të pedagogjisë për nxënësit normalistë dhe mësuesit e shkollave fillore. Këto ishin: "Fillimet e didaktikës e të edukatës"(1926), "Psikologjia" (1933), "Didaktika" (1937) etj. Të gjitha ato kishin karakter të theksuar kombëtar e frymë popullore, me një nivel të lartë shkencor. Synimi ishte që të përgatiteshin e të aftësoheshin sa më mirë për jetën mësimdhënësit e ardhshëm për shkollat shqipe, deri në krahinat më të thella të vendit.

Për mbarëvajtjen e kësaj vatre të shquar të përgatitjes dhe aftësimit të mësimdhënësve shqiptarë, nuk kursyen energjitë e tyre mendore as dituritë e tyre të shumta, disa drejtues të saj.

Ndër ta, përmendim Luigj Gurakuqin (drejtor i parë), Aleksandër Xhuvanin, Sali Çekën, Ahmet Gashin e të tjerë. Ndërsa mësues ishin atdhetarë e personalitete të

Vijon në faqen 14

Vijon nga faqja 13

njohura, si Sotir Peci (më vonë ministër i Arsimit), Simon Shuteriqi, Kostaq Cipo, Peter Dodbiba, Ibrahim Dalliu, Hajdar Blloshmi, Hasan Mazja, Dhimitër Kristo, Vasil Andoni, Dhimitër Paparisto, Qemal Përmeti, Kostaq Cipo, Luigj Filaj, Sulë Harri, Fadil Gumani, Karl Ljarja, Selim Alliu, Gani Daiu, Skënder Sejdini, Shaban Arra, Kasem Bajrami (Malasi), Eqrem Çabej, Kolë Popa, Kolë Paparisto, Mahir Domi, Veniamin Dashi, Ahmet Duhanxhiu, Kahreman Ylli, Qamil Guranjaku e të tjerë.

Matura e parë e Normales së Elbasanit (me tri klasë dhe një gatimore) doli në vitin 1924 dhe ata u shpërndanë kudo në shkollat e Shqipërisë, por dhe të Kosovës. Me rastin e përfundimit të provimeve, u organizua një ceremoni e bukur, ku foli drejtori i saj, Luigj Gurakuqi. Duke përshkruar jehonën e çeljes së kësaj shkolle, ai theksoi:

"Shqipëria u lëkund e tëra nga zëri i shkollës Normale; atdhetarët shqiptarë, që prej sa kohe kishin një etje të madhe për mësim e për dituri, nuk i kursyen ndihmat e veta të begata, e djemtë tanë rodhën nga të gjitha viset e Shqipërisë e u dërdhën këtu në Elbasan.

Kështu që sot mund të themi me një pëlqim të parrëfyeshëm se kjo shkollë, e cila u hap e u nis nga vetëm 50 nxënës, sot ka të shkruar më tepër se 150, të ndarë në katër rende, një të shkollës fillore e tri të Premtares. E jo vetëm nga Toskëria, që ka qenë gjithmonë e para ndër tregimet kombëtare e ndër luftërat e gjuhës, po më fort nga Gegëria e sipërme, nga ajo Kosova fisnike e trimoshe, me të përpjekurit e të ndershmit Hasan be Prishtina, i cili na rroftë për jetë, na erdhën mjaft nxënës, sa që mund të thuhet, pa frikë lajthimi, se nuk ka kënd të Shqipërisë, që mos të ketë këtu mbrenda përfaqësuesin e tij"..

Por kjo shkollë Normale nuk e pati jetën të gjatë dhe nuk u lejua të vazhdonte rregullisht. Kështu, pas një viti veprimtarie frytdhënëse, atë e mbyllën pushtuesit osmanë. Me përpjekjet e mësuesve dhe kërkesat këmbëngulëse të popullit, u riçel nga mesi i vitit arsimor 1911-1912. Megjithatë, u mbyll përsëri, kur Shqipëria e Mesme u pushtua nga ushtria shoviniste serbe dhe u rihap pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në vitin arsimor 1913-1914. Deri në Kongresin e Lushnjës (1920), ajo u mbyll e u rihap pesë herë.

Shkolla Normale e Elbasanit la gjurmë të pashlyera në jetën e arsimit dhe të kulturës tonë kombëtare e të mbarë vendit, në përgjithësi. Ajo luajti rol të madh në disa drejtime kryesore: në përgatitjen e mësuesve të rinj dhe aftësimin e mëtejshëm të atyre ekzistues, mësimdhënien e gjuhës amtare, organizimin e praktikave pedagogjike, hartimin dhe botimin e teksteve mësimore, të shtypit pedagogjik etj. Në vitin arsimor 1923-1924, pranë saj u çel shkolla ushtrimore, e cila solli një ndihmesë të vyer në përgatitjen pedagogjike të mësuesve të ardhshëm. Është për t'u shënuar dhe botimi i revistës mujore "Normalisti", e cila doli aty në vitet 1929-1937.

Roli i mësuesve dhe i nxënësve të shkollës Normale të Elbasanit ishte i madh, si gjatë lëvizjes demokratike në vitet '30, në qendresën antifashiste dhe në vitet e Luftës II Botërore. Me dhjetëra prej tyre morën pjesë me armë në dorë e rreth 70 nga ata dhanë jetën për çlirimin e Atdheut

Pas çlirimit të Shqipërisë, ajo u quajt shkollë pedagogjike dhe iu vu emri i drejtorit të parë të saj, "Heroit të Popullit" e "Mësuesit të Popullit", Luigj Gurakuqi. Ndër drejtorët e saj të nderuar të atyre viteve ishte dhe "Mësuesi i Popullit" Vasil Kamami. Me mijëra mësues kanë dalë nga dyert e kësaj shkolle dhe qindra të tjerë janë kualifikuar aty. Dijet dhe përvojën e tyre ata i kanë vënë dhe i venë në shërbim të zhvillimit të arsimit tonë kombëtar, të mbarëvajtjes së shkollës sonë shqipe, për të cilën kanë punuar e sakrifikuar breza të tërë. Me rastin e festimeve të 25-vjetorit të kësaj shkolle, në mes të tjerave, prof.dr. A.Xhuvani nënvizoi: *"Mësuesit e dalë prej Normales nuk u kanë dhënë bijve të popullit vetëm dituri fillestare, por kanë vepruar mbi zemrat e tyre, kanë zgjuar ndjenjat kombëtare dhe kanë predikuar vllazërimin dhe bashkimin e Kombit"*.

Janë këto arsye dhe shumë të tjera, që kanë çuar në vlerësimin e lartë, që është bërë për këtë vatër të zjarrtë diturie e atdhetarizmi, duke e quajtur në mënyrë simbolike "Universiteti i parë shqiptar".

Në çdo festë të 7 Marsit, pra dhe sivjet, kur ajo mbush 100-vjetorin e themelimit, brezat e panumërt të pedagogëve të Normales së Elbasanit, por dhe mijëra ish-nxënës e prindërit e tyre, kujtojnë me nderim e respekt udhën e ndritur, që ka përshkuar dhe sjellin ndërmend rolin e madh në ndriçimin e mendjeve të rinisë e mbarë popullit tonë.

Të reja shkencore

Parashikime qesharake në lidhje me teknologjinë

Unë parashikoj që së shpejti interneti do të shkatërrohet në mënyrë katastrofike, tamam si fenomeni supernova (shpërthim i fuqishëm yjesh).

Robert Metcalfe, krijuesi i 3Com, 1995



Metcalfe njihet për largpamësi në lidhje me teknologjinë. Ai është edhe krijuesi i Ethernet. ky pohim për internetin ka qenë komenti për të cilën është penduar më shumë gjatë të gjithë jetës. Por kishte premtuar që të bënte publik përgënjeshtrimin e këtyre fjalëve nëse do të ishin të gabuara dhe e ka mbajtur këtë premtim në 1999, gjatë International World Wide Web Conference.

Ndër personat madhorë, 97 million përdorues të internetit kanë kërkuar lajme online në vitin 2005, 92 million kanë blerë të paktën një produkt dhe 91 million kanë bërë një rezervim bilete avionic.Tre të katërtat e amerikanëve kanë akses në internet, duke kaluar aërsisht dymbëdhetë orë e gjysëm në javë online. Përdorimi i e-mailit mbetet në vend të parë.

"Apple" ka vdekur tashmë

Nathan Myhrvold, ish drejtor i teknologjisë tek Microsoft, 1997



Për të qenë të drejtë, duhet të pranojnë që pothuajse të gjithë në biznesin e kompjuterave e kanë menduar këtë.

Kush do të kishte parashikuar që pak më shumë se një dhjetë vjet më vonë Apple do të kishte këtë sukses duke fituar të gjithë tregun e telefonisë me iPhone?

Në një studim të vitit 1999, 77% e firmave pranuan se po planifikonin të blenin një kompjuter Macintosh.

Pas dy vjetësh problemi i "Spam"-eve do të jetë zgjidhur

Bill Gates, krijuesi i Microsoft, 2004



Nga shifrat e kohëve të fundit, sasia e "Spam"-eve që janë të pranishëm në rrjet shkon në 92% e të gjithë mesazheve e-mail në të gjithë botën.

Televisorët nuk do të jenë të gjendje të mbijetojnë më shumë se gjashtë muaj. Shumë shpejt njerëzit do të lodhen duke parë çdo natë një kuti me kompesatë druri

Darryl Zanuck, drejtori i përgjithshëm i "20th Century Fox", 1946

Ja disa statistika të Shteteve të Bashkuara:

Përqindja e shtëpive që kanë të paktën një televizor: 99

Përqindja e shtëpive me më shumë se tre televizorë: 66

Numri i orëve që televizori qëndron hapur (në ditë): 6 orë, 47 minuta

Përqindja e Amerikanëve që shohin TV rregullisht gjatë



vaktit të darkës:66

Numri i videove që merren me qera përditë në USA: 6 million

Përqindja e Amerikanëve që pranojnë se shohin shumë TV:49

Nuk mendoj se ka arsye se pse çdokush do të dojë të ketë një kompjuter në shtëpi

Ken Olsen, krijuesi i Digital Equipment Corp., 1977



Sipas statistikave në Mbretërinë e Bashkuar, numri i shtëpive që kishin një kompjuter në shtëpi u rrit nga 67 në 70 % midis viteve 2006 dhe 2007.

Këshilla praktike

GJASHTË KËRKESA PËR TË PATUR NJË JETË MË TË SHËNDETSHME

1. Pini ujë me çdo ushqim

Uji parandalon që qelizat të ngjiten me njëra tjetrën dhe luan rol të rëndësishëm në pothuajse çdo funksion jetësor të trupit. Etja lidhet me ndjesitë e konfuzionit dhe ngathtësisë.Hidratimi i përshtatshmë mund të jetë kura për të gjithë lodhjen e trurit, meqënëse oksigjeni, si përbërës i ujit, jep një rritje natyrale të energjive, pa shtuar kalori ose kimikate. Sasia e ujit që duhet pirë për të patur një hidratim të përshtatshmë varion në varësi të nivelit, sasisë, aktivititetit tuaj, djersitjes dhe klimës në të cilën jetoni. Në përgjithësi, 8 deri në 12 gota unë në ditë do të ishin të mjaftueshme.

2. Krijoni një regjim në mëngjes që të përmbajë edhe fibra edhe proteina

Një tost me bukë gruri do të ishte i përshtatshëm.

Provoni të bardhat e vezëve. Një vezë e plotë përmban afërsisht 80 kalori, ndërkohë që vetëm e bardha 20. Përgatisni një vezë të tërë dhe shtoni vetëm të bardhat e nja dy vezëve të tjera. Po t'i shoqëroni me domate, kripë dhe piper, do të shihni sa të shijshme janë.

3. Flini shtatë deri në nëntë orë gjumë në natë

Gjumi i mjaftueshëm është thelbësor për rënien në peshë. Është bërë një studim për zakonet e gjumit të 238.000 infermiereve gjatë 16 viteve. Rezultati ishte: Gratë që flinin më pak se 7 orë në natë peshonin më shumë se ato që flinin shtatë ose më shumë orë.

Mund edhe të zëvendësoni orët e munguara të gjumit thjesht duke dremitur pak gjatë ditës, 20 deri në 30 minuta. Kjo do t'ju bëj të ndjeni të mirat rigjernuese të gjumit pa patur lodhjen që ndjehet zakonisht kur fle shumë dhe bën gjumë të rëndë.

4. Ecni për të paktën 30 minuta pothuajse çdo ditë dhe bëni gjimnastikë katër deri në pesë here në javë me intesitet më të lartë për të paktën 20 minuta

Të ecurit i bën shumë mirë zemrës dhe ndihmon në pastrimin e mendimeve. Merrni iPod-in me vete që të mos mërziteni shpejt.

Të bërit gjimnastikë për katër ose pesë herë në javë do t'ju tonifikojë trupin dhe do të largojë streset e ditës

5. Krjoni një vakt të ndermjetëm në mëngjes dhe mbasdite

Natën, para se të shkoni në punë, planifikoni që më parë diçka të vogël, (jo më shumë se 100 kalori), për ta ngrënë rreth orës 11 dhe një më të bollshëm, (100-200 kalori), për mbasditë. Mos u justifikoni duke thënë që nuk keni kohë, kur shpenzoni aq shumë duke menduar për rrobat që ju shkojnë më shumë ose për ato që ju tregojnë më të hollë.

6. Pini jo më shumë se një pije alkolike në ditë

Duke ditur të mirat dhe rreziqet e alkolit, është e rëndësishmë të bësh disa zgjedhje në të mirë të shëndetit. Çdo pijeje alkolike shtojini pak ujë. Hollojeni verën e bardhe duke përdorur pak ujë të gazuar. Porosisni verë të bardhë të thatë dhe jo të ëmbël. Pini ujë tonik me pak vodkë.

Përgatiti faqen Eriona Vangjeli

Tribuna sindikale

